



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-141

Prishtinë, më 20 janar 2014, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 20 JANAR 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Albert Kinolli, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavleviq, Myfera Shinik dhe Sasha Gjokiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 dhjetor 2013,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 dhjetor 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 30 dhjetor 2013.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet më 23 janar 2014, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Debat parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës së Amortizatorëve në Zonën Industriale të Prishtinës,
5. Debat parlamentar për procesin e privatizimit të Fabrikës për Prodhimin e Gypave në Ferizaj,
6. Raporti i Qeverisë së Kosovës për ecurinë e procesit të negocimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportet e auditimit në Ministrinë e Shëndetësisë, Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe raportin e auditimit mbi menaxhimin e mbeturinave medicinale për vitin 2012,

8. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

1. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2014

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; dhe Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

1. Programi legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2014 t'u shpërndahej të gjithë deputetëve të Kuvendit.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që mbi bazën e Programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2014 dhe të propozimeve të veta t'i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2014 deri më 29 janar 2014.

3. Kërkohej nga Komisioni për Legjislacion që në programin e punës për vitin 2014 të përfshijë hartimin e Projektligjit për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

4. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që në bazë Programit legjislativ të Qeverisë së Kosovës dhe planeve të punës së komisioneve parlamentare ta hartojë Propozim-programin e punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2014 deri më 3 shkurt 2014, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit i procedohet seancës plenare për miratim.

2. Kërkesë për mbajtjen e një seance të veçantë kushtuar Çmimit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me kërkesën e lartpërmendur, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Kërkohej nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë kërkesën për mbajtjen e një seance të veçantë kushtuar Çmimit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut dhe Kuvendit t'ia paraqesë rekomandimin lidhur me këtë çështje.

3. Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e kryesuesit dhe anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit; Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve lidhur me propozimin e lartpërmendur, nxori këto përfundime:

I.

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës që sa më parë ta propozojë edhe kandidatin e pestë për anëtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

II.

P ë r f u n d i m

Kërkohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës që në pajtim me nenin 100.4 të Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik në Kosovë t'i caktojë tre gjykatës për anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur që do të emërohen nga Kuvendi për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit.

4. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesia e radhiti propozimin e lartshënuar në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

5. Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bosnjë-Hercegovinë prej 17- 21 mars 2014

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartpërmendur, mori këtë:

V e n d i m

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës: Xhavit Haliti dhe Petar Miletqi, si dhe zyrtarja e Administratës, Ariana Musliu-Shoshi për të marrë pjesë në Seminarin e 85-të të NATO-s, që do të mbahet në Bosnjë-Hercegovinë prej 17-21 mars 2014.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

6. Njoftimi me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetit

Kryesia e radhiti njoftimin e lartshënuar në rend të ditës për seancën plenare të radhës.

7. Njoftimi i deputetëve lidhur me vizitën zyrtare, të realizuar në Francë, prej datës 10-12 dhjetor 2013

Kryesia u njoftua me vizitën zyrtare të realizuar nga deputetët në takimet e komisioneve parlamentare të Këshillit të Evropës në Francë, prej datës 10-12 dhjetor 2013.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale